

**VENDIM**  
**Nr. 767, datë 12.11.2014**

**PËR SHPALLJEN “QENDËR  
HISTORIKE” TË NJË ZONE NË  
QYTETIN-MUZE TË BERATIT DHE  
MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR  
MBROJTJEN, KONSERVIMIN E  
INTEGRUAR, ADMINISTRIMIN E  
“QENDRËS HISTORIKE” DHE ZONËS  
SË MBROJTUR TË QYTETIT TË  
BERATIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 3 e 4, të nenit 29, të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen “Qendër Historike” në qytetin-muze të Beratit të zonës, sipas hartës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Miratimin e rregullores “Për mbrojtjen, konservimin e integruar dhe administrimin e “Qendrës Historike” dhe zonës së mbrojtur të qytetit të Beratit”, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.


3. Vendimi nr. 826, datë 28.12.2005, i Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e “Qendrës Historike” të një zonë në qytetin muze të Beratit dhe miratimin e rregullores së administrimit të kësaj qendre”, shfuqizohet.

4. Ngarkohen Ministria e Kulturës dhe bashkia e Beratit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Edi Rama**

**ZONIFIKIMI I QENDRËS HISTORIKE DHE ZONËS SË MBROJTUR TË QYTETIT BERAT**



**LEGJENDA**  
--- QENDRËSA HISTORIKE  
--- ZONË E MBROJTUR  
[Pattern] KATEGORIA I  
[Pattern] KATEGORIA II  
[Pattern] KATEGORIA III  
[Pattern] KATEGORIA IV

**MBRATOHJET:**  
KRYEMINISTRI  
EDI RAMA

**MINISTRIA E KULTURËS**  
MINISTRI  
MIRELA KUMBARO FURCË

**INSTITUTI I MONUMENTEVE TE KULTURËS "GJANI STRAZIMIRI"**  
DREJTORI  
ARTA DOLLANI

VENDIMI NR. DATE \_\_\_\_ 2014

**RREGULLORE**  
**E MBROJTJES, KONSERVIMIT TË INTEGRUAR DHE ADMINISTRIMIT TË QENDRËS**  
**HISTORIKE DHE ZONËS SË MBROJTUR TË QYTETIT TË BERATIT**

Neni 1

**Qëllimi dhe objektivat**

Kjo rregullore përcakton detyrimet dhe mënyrat për mbrojtjen, konservimin e integruar dhe administrimin e vlerave historiko - kulturore të Qendrës historike dhe Zonës së mbrojtur të qytetit të Beratit.

Për vlerat e rëndësishme historiko- kulturore, Berati tradicional, me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 172, datë 2.6.1961, është shpallur "qytet-muze" dhe vënë në mbrojtje shtetërore. Për vlerat e pakrahasueshme universale, qendrat historike të qytetit të Beratit dhe të Gjirokastrës janë shpallur "Pasuri botërore" në Seri në vitin 2008 si shembuj të rrallë të arkitekturës tipike të periudhës osmane.

Objektivat kryesorë të kësaj rregulloreje janë:

1. Administrimi i qendrës historike dhe zonës së mbrojtur të qytetit-muze të Beratit sipas hartës së zonifikimit, që i bashkëngjitet kësaj rregulloreje si pjesë integrale e saj.
2. Mbrojtja, konservimi dhe restaurimi i vlerave historiko-kulturore të qendrës historike të qytetit-muze të Beratit.
3. Mënyrat e bashkëpunimit me njësitë e qeverisjes vendore të qytetit të Beratit për administrimin, mbrojtjen dhe restaurimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të qendrës historike të qytetit-muze të Beratit.

Neni 2

**Struktura e hapësirës urbane në mbrojtje**

Hapësira urbane në mbrojtje e qytetit të Beratit, për vlerat e saj historiko-kulturore, dhe si pjesë e trashëgimisë kulturore i nënshtrohet ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003 "Për trashëgiminë kulturore", të ndryshuar me ligjin nr. 9882 datë 28.2.2008 dhe ligjit nr. 9386, datë 4.5.2005 "Për muzetë".

Hapësira urbane në mbrojtje e qytetit të Beratit përbëhet nga:

1. Qendra historike;
2. Zona e mbrojtur.

Plani i përgjithshëm vendor i qytetit të Beratit duhet të marrë parasysh kufijtë dhe kriteret e mbrojtjes të qendrës historike dhe zonës së mbrojtur.

Neni 3

**Qendra historike dhe kufijtë e saj**

Qendra historike është pjesa me vlera urbanistik-arkitektonike e qytetit të Beratit. Ajo ruan gjini të ndryshme ndërtimore të periudhave prej shekullit IV p.e.s. dhe deri më sot, në shkallë të ndryshme autenticiteti. Këto ndërtime janë të lidhura me mjedisin tradicional, i cili është pjesë e qendrës historike. Qendra historike përmbledh brenda kufijve të saj:

Lagjen Kala, lagjen Mangalem, lagjen Goricë, si dhe Qendrën Mesjetare Islamike.

Kufijtë e saj janë: Lapidari në qafën e kalasë, ndjek rrugën e vjetër që zbrit në qendër të Beratit, duke e përfshirë atë në të dy krahët, kthehet te Qendra Islamike me xhaminë Mbret, Teqenë Helvetive dhe Konakët e Teqesë. Këtu përfshihen të gjitha mjediset dytësore dhe portat e banesave që rrethojnë Qendrën Islamike, del te cepi i markatës dhe në rrugën kryesore. Nga këtu merr rrugën drejt Mangalemit, pas Pallatit të Kulturës duke e përfshirë dhe rrugën, dhe del para xhamisë së Beqarëve dhe kalon drejt, del matanë lumit në Goricë. Lagjja Goricë përfshihet me gjithë kurorën e

gjelbër deri në izoipsin 200 m, zbret në drejtim të urës së Goricës, del në rrugën kryesore duke u ngjitur përbri memorialit të Skënderbeut, ngjitet deri në izoipsin 150 m mbi banesat e lagjes Muzaka, duke pasur brenda dhe kurorën e gjelbër poshtë mureve të kalasë dhe bashkohet te lapidari në qafën e kalasë.

Kufijtë e qendrës historike janë kufijtë e shpallur “Pasuri botërore”, paraqiten në hartën e zonifikimit të qytetit të Beratit e cila është pjesë kësaj rregulloreje.

#### Neni 4

### **Ndërhyrjet e lejuara në qendrën historike**

Në qendrën historike nuk lejohen ndërtimet e reja. Me qëllim ruajtjen e vlerave urbanistiko - arkitekturore të qendrës historike brenda kësaj zone lejohen vetëm këto ndërhyrje:

1. Ndërhyrje sistematike konservuese, restauru-ese dhe të mirëmbajtjes sipas parimeve të konservimit të integruar.

2. Ruajtja dhe përfshirja e vlerave mjedisore duke mbajtur të pandryshuar konfiguracionin e truallit dhe llojshmërinë e drurëve dhe bimësisë tradicionale.

3. Konservimi i rrënojave të ndërtimeve me konture të qarta murature, në hapësirën e qendrës historike, për të penguar degradimin e mëtejshëm të tyre. Kur rrënojat ruhen në lartësi mbi 3m dhe cenojnë dukshëm njësinë e ansambleve, brenda të cilëve përfshihen, mund të kryhet rikonstruksioni në të njëjtin volum, mbi strukturën ekzistuese (mureve perimetral) bazuar në dokumentacionin e qartë fotografik, grafik, mbështetur në tipologjinë, trajtimin arkitektonik dhe teknikën tradicionale në pjesët e dukshme.

4. Në raste fatkeqësish natyrore, të shembjeve ose djegies së objekteve me vlera të trashëgimisë kulturore, rikonstruksioni mund të kryhet mbi strukturat ekzistuese, sipas formulimit kompozicional dhe arkitektonik të gjendjes para rrënimit, bazuar në dokumentacionin e qartë fotografik, grafik etj.

5. Objektet pa status brenda ansambleve arkitektonike të qendrës historike, ndërtuar në vitet 1950 – 1990, të cilat me volumet dhe formulimin e tyre arkitektonik, dëmtojnë vlerat dhe unitetin kompozicional të qendrës historike, nëpërmjet studimesh rehabilitimi mund të parashikohen përshtatje në harmoni me ansamblin arkitektonik ku bëjnë pjesë.

6. Ndërtimet pa leje brenda qendrës historike evidentohen nga ana e Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare Berat, nëpërmjet monitorimit të vazhdueshëm. Nga ana e DRKK-së Berat, në bashkëpunim me Institutin e Monumenteve të Kulturës, hartohet plan veprimi për trajtimin e ndërtimeve të paligjshme, i cili miratohet në KKR. Vendimi për trajtimin e tyre merret në përputhje me plan veprimin dhe miratohet nga ana e KKR-së.

7. Ndalohen ndërtimet e reja në qendrën historike me përjashtim të rikonstruksionit të rrejtët inxhinierik nëntokësor dhe rikonstruksioneve të përmendura në pikat më sipër.

#### Neni 5

### **Zona e mbrojtur dhe kufijtë e saj**

Zona e mbrojtur shtrihet përreth qendrës historike. Ajo me vlerën e saj historiko-kulturore, plotëson edhe pasuron vlerat e qendrës historike. Zona e mbrojtur ruhet në përbërësit urbanistikë, arkitekturorë dhe mjedisorë.

Kufijtë e zonës së mbrojtur përfshijnë: majën e kodrës në kalanë e Biftës duke kaluar në izoipsin 200 m, zbret drejt Lagjes së Bregut ku lë brenda zonës gjithë faqen që duket nga qendra e Beratit, me pronësitë 9/48, 9/47, 9/46, 9/45, 9/40, 9/32, 9/25, ku kalon në rrugën 9/20 duke lënë brenda zonës pronësitë 10/59, 10/60, 10/61, ndjek rrugën 10/58, 10/27, lë brenda pronësitë 10/29, 10/52, 10/ 1003, 26/59, 26/61, 26/56, 26/44, 26/39, 27/9 ndjek rrugën 27/6, lë brenda 1/2, 1/4, 1/10, 1/21, 1/14, 2.47, 2/17, del në rrugën 2/36, ndjek rrugën 2/50, duke përfshirë kodrën e Shën

Thanasit ku përfshihet maja e saj me izoipsin 150 m, zbret në rrugicat 3/129, 3/124, 3/120, ndjek rrugën 5/152, që të nxjerrin te burimi në rrugën kryesore 15/4, mban stadiumin e vjetër brenda saj, mban rrugën 14/75 dhe pronën 13/8, kalon lumin dhe ngjitet drejt kurorës së gjelbër në Goricë në izoipsin 275 m, përfshin rrënojat e kalasë së Goricës dhe zbret poshtë urës së Goricës duke përfshirë godinën e shekullit të 20-të, 14/124 së bashku me ish-mullirin pranë urës, ngjitet në rrugën perëndimore të kalasë mbi lagjen “Muzaka” dhe bashkohet te kodra e Biftës.

Kufijtë e zonës së mbrojtur janë kufijtë e shpallur “Pasuri botërore”.

Zona e mbrojtur për veçoritë e ndryshme që ka në të gjithë hapësirën e saj ndahet në katër nën zona sipas hartës bashkëngjitur:

- Nënzona I (veriperëndimore);
- Nënzona II (jugore);
- Nënzona III (lindore fushore);
- Nënzona IV (lindore kodrinore);
- Kufijtë e zonës së mbrojtur dhe kufijtë e nënzoneve paraqiten në hartën e zonifikimit të qytetit të Beratit e cila është pjesë kësaj rregulloreje.

Neni 6

### **Ndërhyrjet e lejuara në zonën e mbrojtur**

Nënzonat brenda zonës së mbrojtur do t’u nënshtrohen masave të ndryshme mbrojtëse specifike për secilën, duke u bazuar në karakteristikat e secilës.

Zona I (veriperëndimore)

Kjo zonë me terrenin e pjerrët që e karakterizon ka qenë dhe mbetet një zonë tërësisht e pandërtuar dhe historikisht pjesë e zonës që mbron Kalanë. Në këtë zonë nuk lejohen ndërtimet e reja, pasi ndërtimi në këtë zonë mund të shkaktojë një dëmtim të pamjes të gjithë kompleksit të qendrës historike. Në këtë zonë kryhen studime për rregullimin e zonës së gjelbër dhe përmirësimin e imazhit të zonës.

Zona II (jugore)

Kjo zonë përfshin kurorën e gjelbër mbi lagjen Goricë ku ndodhen dhe rrënojat e kalasë së Goricës dhe shtratin e lumit Osum. Në këtë zonë ruhen vlerat mjedisore dhe arkeologjike duke mbajtur të pandryshuar konfiguracionin e truallit dhe llojshmërinë e drurëve e bimësisë tradicionale. Në këtë zonë nuk lejohet asnjë lloj ndërtimi i ri.

Zona III (lindore fushore)

Në këtë zonë përfshihet qendra urbane e qytetit. Për vetë terrenin fushor në të cilin shtrihet, kjo zonë paraqet një rëndësi të veçantë për mbrojtjen e qendrës historike. Ndërhyrjet e lejuara në këtë zonë janë:

1. Ruajtja e hapësirave të gjelbra ekzistuese, si dhe raportit ekzistues sipërfaqe e ndërtuar dhe zonë e gjelbër, e cila lejon fushëpamjen e qendrës historike nga qyteti.

2. Ndërtesat që kanë statusin “Monument” brenda kësaj zone iu nënshtrohen vetëm ndërhyrjeve konservuese restauruese.

3. Në këtë zonë mund të bëhen ndërtime të reja ose rikonstruksione të ndërtesave ekzistuese. Ndërtimet duhet t’u përmbahen disa specifikimeve për të mbrojtur pamjen dhe profilin e qytetit:

- Lartësia maksimale e lejuar për ndërtimet në këtë zonë është 5 kate, jo më tepër se 17 m deri në kornizën e çatisë.

- Nuk lejohen ndërtime me forma gjeometrike komplekse duke qenë se janë në kontrast me traditën ndërtimore lokale.

- Nuk lejohet ndërtimi i objekteve me karakter industrial.

- Nuk lejohen mbulimet e ndërtesave me çati me ngjyra të tjera ose me mbulesa të ndryshme nga forma tradicionale që janë lehtësisht të dallueshme brenda zonës.

- Ngjyrat e përdorura do të jenë në përputhje me ndërtimet tradicionale.
- Zona IV (lindore kodrinore)

Kjo zonë ndodhet në lindje të qendrës historike dhe në veri të qendrës së qytetit. Pjesa kodrinore në këtë zonë që nga periudha osmane ka qenë me ndërtesa 2-3 kate me oborr. Ndërhyrjet e lejuara brenda kësaj zone janë:

1. Ndërtesat që kanë statusin “Monument” brenda kësaj zone i nënshtrohen vetëm ndërhyrjeve konservuese restauruese.

2. Lejohet të bëhen ndërtime të reja ose rikonstruksione të ndërtesave ekzistuese. Këto ndërtime do të kenë kufizime në lartësi, vëllim, formë, material dhe ngjyrë:

- Lartësia maksimale e lejuar për ndërtimet në këtë zonë është 3 kate, jo më tepër se 11 m deri në kornizën e çatisë.

- Në kompozimin arkitektonik të ndërtesave duhet të përdoren elementë morfologjikë të arkitekturës tradicionale.

- Nuk lejohen ndërtime me forma gjeometrike komplekse duke qenë se janë në kontrast me traditën ndërtimore lokale.

- Nuk lejohet ndërtimi i objekteve me karakter industrial.

- Ndërtesat e reja me destinacion banim të kenë lartësi 2-3 kate dhe duhet të mbulohen me çati 4-ujëse, sipas tipologjisë tradicionale.

- Nuk lejohen mbulimet e ndërtesave me çati me ngjyra të tjera ose me mbulesa të ndryshme nga forma tradicionale që janë lehtësisht të dallueshme brenda zonës.

- Ndërtesat e radhës së parë në rrugën nacionale, në të dy anët e saj , duke filluar nga Markata e deri në fund të kufirit të zonës së mbrojtur do të kenë karakteristikat e nënzonës III.

- Për ndërtimet në këtë zonë suvatimi i jashtëm është i detyrueshëm.

- Ngjyrat e përdorura do të jenë në përputhje me ndërtimet tradicionale.

#### Neni 7

### **Rrugët dhe sheshet**

Rrugët dhe sheshet e qendrës historike dhe zonës së mbrojtur ruhen në formulimin kompozicional si pjesë organike e këtyre zonave.

Në qendrën historike:

Lejohen ndërhyrje për përmirësimin e infrastrukturës mbi dhe nëntokësore, projekti i të cilave miratohet në KKR.

Ndërhyrjet e rikonstruksionit në rrjetin rrugor dhe sheshe ruajnë detyrimisht materialet dhe teknikat tradicionale. Drurët dhe gjelbërimi tradicional në këtë zonë ruhen dhe pas degradimit ripërtërihen me të njëjtat lloje.

Në zonën e mbrojtur:

Lejohet rikonstruksioni i rrjetit rrugor dhe shesheve, duke përdorur materiale tradicionale.

#### Neni 8

### **Klasifikimi i objekteve brenda qendrës historike**

Objektet brenda qendrës historike klasifikohen si më poshtë:

- a) Monumente të kulturës të kategorisë së parë;
- b) Monumente të kulturës së kategorisë së dytë;
- c) Objektet pa status pjesë e ansambleve arkitektonike të qendrës historike.

#### Neni 9

## **Monumentet e kategorisë së parë**

Monumentet e kategorisë së parë janë ndërtimet me vlera të rëndësishme tipologjike dhe arkitektonike. Monumentet e kategorisë së parë, me shkallë të mirë autenticiteti, ruhen në përbërësit kompozicionalë, arkitekturorë, teknikë dhe të materialeve të ndërtimit. Oborri, muret rrethuese porta e jashtme dhe ndërtimet ndihmëse, janë pjesë organike e monumentit dhe si të tillë i nënshtrohen të njëjtit trajtim.

Monumentet e kategorisë së parë ruhen në qendrën historike, në zonën e mbrojtur dhe në pjesën tjetër të qytetit.

Në monumentet e kategorisë së parë kompozimi i vëllimeve, trajtimi arkitektonik i pamjeve të jashtme dhe të brendshme, si dhe zgjidhja planimetrike dhe funksionale, nuk mund të ndryshohet, me përjashtim të vendosjes së njëjës higjieno-sanitare kur është e domosdoshme dhe nuk cenon vlerat për të cilat është vënë në mbrojtje.

Deri në shpalljen e zonës së mbrojtur të monumenteve të kategorisë së parë, nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore, në përputhje me nenin 32 të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore” i ndryshuar, për aq sa nuk bie në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregulloreje, nuk lejohen ndërtime të reja në distancë jo më pak se 50 m larg nga mureve rrethuese nëse ka apo nga muret e objektit.

Trajtimi i objekteve ekzistuese brenda kësaj rrezeje, të shqyrtohet në KKR rast pas rasti.

Neni 10

### **Monumente të kategorisë dytë**

Monumentet e kategorisë së dytë janë ndërtimet me vlera historiko- kulturore, kryesisht si bashkëformuese ansamblesh urbanistiko- arkitekturorë, por edhe si vepra të veçanta.

Monumentet e kategorisë së dytë ruhen në volumet e tyre dhe trajtimin e tyre arkitekturor të pamjes së jashtme, duke përfshirë materialet dhe teknikat tradicionale. Kur brenda këtyre monumenteve, sidomos në objektet e banimit, ruhen ambiente karakteristike, si dhe gdhendje në dru, punime në allçi, dekorime pikturale ose mobilie arkitektonike me vlerë, këto ruhen në vendin ku janë.

Në brendësi të monumenteve të kategorisë së dytë lejohen ndryshime të strukturës kompozicionale dhe përdorimin e teknikave bashkëkohore, pa cenuar formulimin e pamjes së jashtme.

Neni 11

### **Objektet pa status pjesë e ansambleve arkitektonike të qendrës historike**

Objektet pa status pjesë e ansambleve arkitektonike të qendrës historike, janë objekte të ndërtuara në vitet 50-90 brenda ansambleve arkitektonike të lagjeve Mangalem, Goricë, Kala, që me volumet dhe formulimin e tyre arkitekturor, nuk janë në harmoni me unitetin kompozicional të këtyre ansambleve.

Neni 12

### **Studimi, projektimi dhe zbatimi i punimeve në qendrën historike dhe monumente të veçanta**

1. Projektet e restaurimit dhe restaurimi i monumenteve të kulturës bëhen nga institucione shtetërore të specializuara dhe nga subjekte të licencuara për këtë qëllim.

Projektet shqyrtohen në këshillin shkencor të IMK-së dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit (KKR).

2. Zbatimi i punimeve të mësipërme kryhet prej DRKK-ve ose prej subjekteve të licencuara për restaurim, nën mbikëqyrjen e supervisorit dhe kolaudatorit, caktuar prej IMK-së. Për monumentet e

kulturës pronë private, pjesa e shpenzimeve që i takon pronarit dhe mënyra e shlyerjes së tyre, bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

- Studimet dhe projektet e rikonstruksioneve të përmendura në pikat 3, 4 dhe 5 të nenit 4 hartohen nga Instituti i Monumenteve të Kulturës (IMK), Drejtoria Rajonale të Kulturës Kombëtare (DRKK - Berat) ose nga persona të licencuar në fushën e restaurimeve për këtë kategori projektsh. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të IMK-së dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit (KKR). Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit për planifikimin e territorit.

- Studimet dhe projektet për ndërhyrje në rrjetin rrugor, infrastrukturën nëntokësore dhe rrjetin inxhinierik hartohen nga Instituti i Monumenteve të Kulturës (IMK), Drejtoria Rajonale të Kulturës Kombëtare (DRKK), Berat, në bashkëpunim me Bashkinë e Beratit ose nga persona të licencuar në fushën restaurimeve dhe në kategoritë përkatëse të punimeve. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të IMK-së dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit (KKR). Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit për planifikimin e territorit.

#### Neni 13

### **Studimi, projektimi dhe zbatimi i punimeve në zonën e mbrojtur**

1. Studimet për rehabilitimin e imazhit të zonës së mbrojtur hartohen nga Instituti i Monumenteve të Kulturës (IMK), Drejtoria Rajonale të Kulturës Kombëtare (DRKK) në bashkëpunim me Bashkinë Berat, ose subjekte të licencuar në fushën e restaurimeve sipas rregullores së miratuar. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të IMK-së dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit (KKR). Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit për planifikimin e territorit.

2. Projektet e rikonstruksionit të ndërtesave në këtë zonë hartohen nga projektues ose subjekte projektuese të licencuar në projektim për kategorinë e mësipërme për fushën e ndërtimit. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të IMK-së dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit (KKR). Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit për planifikimin e territorit.

3. Zbatimi i punimeve të rikonstruksionit kryhet prej subjekteve ndërtimore që janë të licencuar për këtë kategori.

4. Projektet për ndërtimet e reja në këtë zonë, hartohen nga projektues ose subjekte projektuese të licencuar në projektim për fushën e ndërtimit. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të IMK-së dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit (KKR). Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit për planifikimin e territorit.

5. Projektet e rikonstruksionit të rrugëve, shesheve dhe infrastrukturës së tyre të përmendura në nenin 7 hartohen nga projektues ose subjekte projektuese të licencuar në projektim për kategorinë përkatëse në fushën e ndërtimit. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të IMK-së dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit (KKR). Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit për planifikimin e territorit.

#### Neni 14

### **Shfrytëzimi i monumenteve**

Monumentet e kulturës shfrytëzohen, sipas rastit, për funksionet për të cilat janë ndërtuar, apo për funksione të tjera me kusht që këto funksione të mos dëmtojnë vlerat për të cilat monumenti është vënë në mbrojtje. Shfrytëzimi i monumenteve të kulturës, për funksione të ndryshme prej atyre për të cilat janë ngritur, bëhet vetëm pasi të jetë marrë miratimi i Këshillit Kombëtar të Restaurimeve.

#### Neni 15

### **Vendosja e elementëve dekorues dhe reklamave**

Në monumentin e kategorisë së parë dhe të dytë nuk lejohet vendosja në mënyrë të ekspozuar e



elementeve të cilat prishin pamjen dhe pengojnë fotografimin, filmimin dhe soditjen normale.

Nuk lejohet vendosja e xhamave me ngjyrë tjetër përveç llojit tradicional.

Vendosja e materialeve publicitare në objektet monument kulture bëhet në raste të veçanta festive-kulturore dhe ka karakter të përkohshëm.

Veprimtaritë kulturore në objektet monument kulture bëhet vetëm në rastet kur ato nuk rrezikojnë ose cenojnë vlerat e tyre.

Ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore, jep lejen për organizimin e veprimtarive kulturore dhe vendosjen e materialeve publicitare.

Neni 16

### **Lëvizja e automjeteve**

Brenda qendrës historike, në rrugët e ngushta, kalldrëme apo në monumente të rëndësishme etj, ndalohet kalimi i mjeteve të rënda, mbi 4 tonë, përveç rasteve të emergjencës, si dhe në rastin e forcave madhore. Në Urën e Goricës ndalohet kategorikisht kalimi i automjeteve.

DRKK-ja Berat, në bashkëpunim me Bashkinë Berat, hartojnë dhe përcaktojnë planin për mënyrat e lëvizjes dhe parkimit të automjeteve në hyrje të Qendrës historike.

Neni 17

### **Masat për mbrojtjen e monumenteve të kulturës nga zjarri**

Çdo objekt, monument kulture, në pronësi private ose shtetërore, brenda qendrës historike të qytetit-muze të Beratit apo jashtë saj, duhet të jetë i pajisur me fikës portativë konform dispozitave ligjore në fuqi.

Bashkia e Beratit si organ i njësisë së qeverisjes vendore, administratore e qytetit, duhet të krijojë kushte për vënien në funksionim të rrjetit të hidrantëve brenda qendrës historike.

Studime për evidentimin dhe menaxhimin e riskut në qendrën historike të qytetit të Beratit hartohen nga Bashkia Berat në bashkëpunim me Institutin e Monumenteve të Kulturës dhe Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Berat dhe miratohen në KKR.

Neni 18

### **Komiteti për koordinimin e planeve të menaxhimit të qendrave historike Berat dhe Gjirokastrë**

Komiteti për koordinim dhe administrim të qendrave historike bashkërendon punën për zbatimin e kësaj rregulloreje dhe për plotësimin e rekomandimeve të vazhdueshme të UNESCO-s.

Kryetar i këtij komiteti është drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit Strategjik të Trashëgimisë Kulturore dhe Diversitetit në Ministrinë e Kulturës. Anëtarë të këtij komiteti janë Drejtorët e DRKK-ve përkatëse, kryetarët e bashkive respektive, drejtori i IMK-së dhe përfaqësues të Ministrisë së Kulturës. Përbërja e Komitetit përcaktohet me urdhër të Ministrit të Kulturës.

Ky komitet funksionon dhe mbledhet sipas rregullores, e cila miratohet në mbledhjen e parë.

Neni 19

### **Dispozitat e fundit**

Për të gjitha çështjet që nuk trajtohen dhe për pasojë nuk zgjidhen në këtë rregullore, sipas kompetencave ato zgjidhen prej Institutit të Monumenteve të Kulturës ose Ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

Për shkeljen e kësaj rregulloreje zbatohen masa ndëshkuese sipas ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar.

Shtesat dhe ndryshimet në këtë rregullore bëhen me propozim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe miratohen nga Këshilli i Ministrave.

Kësaj rregulloreje i bashkëngjitet zonifikimi i qendrës historike dhe zonës së mbrojtur të qytetit të

Beratit dhe lista e monumenteve të kategorisë së parë dhe të dytë objekteve pa status brenda qendrës historike.

Shkelja e kësaj rregulloreje shkakton përgjegjësi, sipas ligjeve në fuqi.

Neni 20

### **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.